

# Ballafaqimi me të kaluarën për një të ardhme më të mirë

Arritja e drejtësisë, paqes dhe kohezionit social  
në rajonin e ish-Jugosllavisë



Përmbledhje - Dokument tematik



COMMISSIONER  
FOR HUMAN RIGHTS

COMMISSAIRE AUX  
DROITS DE L'HOMME

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

# Përmbledhje

---

Kur kanë kaluar thuajse tri dekada nga përfundimi i luftërave që copëtuan rajonin e ish-Jugosllavisë (rajonin) në vitet 1990, nuk ka mbetur shumë kohë për arritur një drejtësi të efektshme, reparacionet dhe të vërtetën për viktimat. Pajtimi dhe kohezioni social mbeten të paarrtshme, madje edhe paqja duket e kërcënuar. Ka hapa pas në proceset e përbaljes me të shkuarën dhe kjo përkon me rënien në shkallë më të gjerë të respektimit të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit në disa vende të rajonit. Një dekadë pas botimit të [Dokumentit të parë Tematik](#) të Zyrës së Komisionerit për Të Drejtat e Njeriut mbi këtë temë, ky Dokumenti Tematik merr në analizë arritjet dhe mangësitë e proceseve të përbaljes me të shkuarën në rajon dhe shqyrton faktorët që pengojnë arritjen e një ndikimi më pozitiv. Në dokument argumentohet se përbalja me një të shkuar që shenjohe nga shkelje të rënda të të drejtave të njeriut nuk është një përpjekje që vështron drejt së shkuarës, por një kusht i nevojshëm për një të tashme dhe të ardhme më të mirë, që bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit.

**Një trashëgimi e konsiderueshme** – Para se të trajtojë sfidat dhe prirjet negative që po ngadalësojnë procesin, Dokumenti Tematik hapet në kapitullin e I me vlerësimin se disa qasje të reja që e kanë zanafillën në rajon ofrojnë trashëgimi të konsiderueshme në fushën e përbaljes me të shkuarën. Vihen në dukje 5 praktika të reja dhe mësimet e nxjerra prej tyre.

Krimet tronditëse që u kryen gjatë luftërave të viteve 1990, të cilat në atë kohë ishin më të rëndat në Evropë që prej Luftës së Dytë Botërore, patën si përgjigje një qëndrim të vendosur kundër pandëshkueshmërisë. Në rajon pati përpjekje të shumëfishta për të siguruar llogaridhënien penale, përfshirë një gjykatë plotësisht ndërkombëtare për krimet, gjykime të brendshme për krimet e luftës si dhe mekanizma të ndërkombëtarizuar ose hibridë të llogaridhënies. Ndonëse janë çuar para drejtësisë disa kriminelë të niveleve të larta, llogaridhënia për krimet e luftës është larg të qenit e plotë. Këto gjykime ndërkombëtare dhe të brendshme dhanë mesazhin e fortë se duhet vendosur drejtësi për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut dhe shtruan rrugën për reagim më të mirë ndaj këtyre krimeve në kontekste të tjera.

Rajoni shihet më tej si model për trajtimin e çështjes së **personave të humbur**. Vlerësohet se më shumë se 70% e personave të humbur gjatë luftërave janë gjetur dhe identifikuar. Pati disa faktorë që ndikuan në këtë

nivel të lartë të zgjidhjes së rasteve, ku përfshihen kornizat e forta ligjore dhe institucionale në nivel kombëtar, të mbështetura që në fillesat e tyre nga organizatat ndërkombëtare, si psh: Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) dhe Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Humbur (KNPH), si dhe përfshirja e efektshme e familjeve të viktimave. Përdorimi i teknologjive moderne për ekspertizën mjeko-ligjore, siç është identifikimi nëpërmjet AND-së, nën drejtimin e KNPH-së ishte faktori kyç. Bashkëpunimi rajonal është kusht për sukses, por është zbehur me kalimin e kohës. Përveç dimensionit humanitar, provat që lidhen me personat e humbur janë përdorur për të siguruar llogaridhënien e personave përgjegjës për zhdukjet e detyruara.

Dokumenti Tematik vlerëson lart **rolin kryesor që ka luajtur shoqëria civile dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut** në përpjekjet për t'u përballur me të shkuarën dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut. Shoqëria civile ka kërkuar me vendosmëri nga autoritetet kombëtare që të zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në këtë fushë dhe ka ndërhyrë shpesh kur shtetet kanë dështuar. Shoqëria civile ka zhvilluar projekte novatore të shumta e të vlefshme, të cilat mund të jenë burim frymëzimi në situata të tjera post-konflikti, shembuj të të cilëve përmenden në Dokumentin Tematik.

Më tej, merren në shqyrtim **mësimet e nxjerra nga komuniteti ndërkombëtar**, ku nënvizohet nevoja për mbështetje konsekuente, afatgjate dhe të mirëkoordinuar. Mbështetja financiare, monitorimi dhe rekomandimet, si dhe presioni politik, në rastin e politikës së kondicionalitetit të BE-së për bashkëpunimin me Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve të Luftës për ish-Jugosllavinë, kanë luajtur rol kryesor në proceset e sigurimit të drejtësisë tranzitore.

Megjithatë, mangësitë e angazhimit të komunitetit ndërkombëtar, përfshirë atë të organizatave ndërqeveritare dhe shteteve të veçanta donatore, si psh: zbehja e angazhimit me kalimin e kohës, vendosja e stabilitetit imediat si përparësi përkundrejt përballjes me të shkuarën; mezazhet jokonsekuente dhe qasja e bazuar në projekte afatshkurtra janë disa nga shkaqet, mes shumë të tjerash, që kanë dobësuar ndikimin e partnerëve ndërkombëtarë. Një mësim që vjen nga rajoni është se përballja me të shkuarën me qëllim pajtimin dhe shmangien e konflikteve në të ardhmen kërkon përpjekje të vazhdueshme që duhet të shtrihen përtej një gjenerate.

Së fundmi, proceset e pasluftës në rajon kanë kontribuar **që të thyhet heshtja për dhunën seksuale të lidhur me konfliktet dhe që të pranohet nevoja për qasje bazuar në ndjeshmëri gjinore** gjatë përballjes me të shkuarën. Kurajoja dhe vendosmëria e grave që i kanë mbijetuar përdhunimit dhe dhunës seksuale ka qenë në themel të risive të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e drejtësisë penale, reparacioneve, përmbushjes së nevojave psikologjike të të mbijetuarve, kërkimit të së vërtetës dhe praktikave të kujtesës që synojnë të trajtojnë

çështjen e dhunës seksuale të lidhur me konfliktet.

**Punë e papërfunduar** - Pavarësisht progresit të lartpërmendur, kapitulli 2 dëshmon se trashëgimia e së shkuarës është e pranishme në rajon, ku shumë procese të drejtësisë transitore kanë mbetur pezull ose nuk kanë marrë zgjidhje.

Thuajse tri dekada pas luftës, kur viktimat, dëshmitarët dhe të dyshuarit janë tashmë të moshuar ose nuk jetojnë më dhe kur provat janë gjithnjë e më pak të disponueshme, **koha për dhënien e drejtësisë nëpërmjet proceseve penale të brendshme** po mbaron. Ka ende mijëra të dyshuar që duhet të ndiqen penalisht. Pavarësisht kësaj ngarkese të prapambetur, vazhdon të ketë ngadalësim të përpjekjeve të drejtësisë, ndërsa strategjitë kombëtare për krimet e luftës mbeten të pazbatuara. Prokurorët e këtyre vendeve nuk janë proaktivë dhe shpesh ndjekin vetëm ato çështje që u transferohen nga vende të tjera kundër autorëve të krimeve të nivelit të ulët apo autorëve të krimeve që i përkasin grupit “tjetër” etnik. Klima e aktuale e mohimit të krimeve të luftës dhe e glorifikimit të kriminelëve të luftës nuk nxit llogaridhënien e efektshme në nivel kombëtar. Mbrojtja e dëshmitarëve dhe ligjet për amnistitë mbeten sfida të vazhdueshme. Një pengesë e rëndësishme për drejtësinë është bashkëpunimi gjyqësor në nivele minimale ose joekzistente mes disa prej vendeve, përfshirë refuzimet e vazhdueshme nga këto shtete për të ekstraduar shtetasit e tyre, të cilët vazhdojnë të gëzojnë pandëshkueshmëri, ndonjëherë nëpërmjet mbajtjes së dy shtetësive të vendeve të rajonit. Kjo ka çuar në rritje të gjykimeve në mungesë, impakti i të cilave është i kufizuar në kuptimin e sigurimit të drejtësisë, duke qenë se autorët e krimeve vazhdojnë të gëzojnë pandëshkueshmëri.

Veç kësaj, shumë viktima civile të luftës në rajon vazhdojnë të mos kenë akses në **reparacione të përshtatshme dhe efektive**. Asnjë nga vendet e përfshira nuk ka miratuar programe të plota për reparacionet që të jenë në përputhje me Parimet dhe Udhëzimet Bazë të Kombeve të Bashkuara Mbi të Drejtën për Zgjidhje Efektive dhe Reparacione. Është dhënë një lloj kompensimi nëpërmjet skemave të përfitimeve sociale; megjithatë ato favorizojnë kryesisht veteranët dhe, për shkak të kriterëve të shumta, përjashtojnë shumë prej viktimave civile të luftës. Për pasojë, këto përfitime perceptohen si selektive dhe, në vend që të njohin dhe nderojnë vuajtjet e viktimave në mënyrë të barabartë, ushqejnë diskursin përçarës rreth viktimave “tona” dhe viktimave “të tyre”. Ndonëse ka pasur një përparim të ngadaltë për njohjen e nevojave të të mbijetuarve të dhunës seksuale nëpërmjet përfshirjes së tyre si viktima civile të luftës në disa legjislacione kombëtare, frika nga stigmatizimi dhe kriteret përjashtuese vazhdojnë t’ua vështirësojnë marrjen e kompensimit të mbijetuarve të dhunës seksuale. Kërkimi i reparacioneve nëpërmjet gjykatave civile apo penale është proces i gjatë dhe i kushtueshëm dhe i ekspozon viktimat ndaj rrezikut të ritraumatizimit. Në përgjithësi, autoritetet kombëtare, përveç kompensimit, i kanë kushtuar pak vëmendje reparacioneve në forma të

tjera, si rehabilitimi, satisfaksioni nëpërmjet zbulimit të së vërtetës, ndjesa publike dhe kujtesa, si dhe garancitë për mospërsëritje.

Shumica e 3,7 deri 4 milionë **personave që u zhvendosën me forcë** gjatë luftërave të viteve 1990 kanë mundur të rikthehen ose kanë gjetur alternativa të arsyeshme. Bashkëpunimi rajonal në këtë fushë është shumë i rëndësishëm.

Megjithatë, personat e zhvendosur forcërisht vazhdojnë të përballen me një numër problemesh të drejtave të njeriut të cilat kanë nevojë për vëmendje.

Thuajse tri dekada pas përfundimit të luftërave, është domosdoshmëri gjetja e një zgjidhjeje të qëndrueshme dhe dinjitoze për personat e zhvendosur që jetojnë ende në banesa kolektive apo të përkohshme. Procesi i rikthimit dhe integritit të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit të tyre vazhdon të pengohet nga diskriminimi dhe armiqësia lokale në zonat ku ata janë pjesë e minoritetit. Komunitetet e zhvendosura Rome, Ashkali, dhe të Egjiptianëve të Ballkanit mbeten kategoria më e cënueshme për shkak të varfërisë dhe paragjyqimeve të vjetra. Duhet të ruhet në rajon angazhimi aktual për zgjidhjen e çështjes së personave pa shtetësi, çka përbën problem kryesisht për këtë popullsi.

Përpjekjet për të ngritur **komisione zyrtare për të vërtetën dhe pajtimin** (KVP) ose lloje të tjera të **mekanizmave zyrtare të kërkimit të së vërtetës** kanë pasur pak rezultate në rajon, pavarësisht projekteve të lëndueshme të shoqërisë civile për kërkimin e së vërtetës. Zhvillim veçanërisht zhgënjyes ka qenë dështimi i qeverive të rajonit në ngritjen e një komisioni rajonal për të vërtetën dhe pajtimin (KRVP). Mungesa e mekanizmave kombëtarë dhe rajonalë të kërkimit të së vërtetës jo vetëm pengon pajtimin, por krijon edhe hapësira për mohimin e krimeve të kryera gjatë luftërave. Një zhvillim shqetësues i viteve të fundit është përpjekja e politikanëve etno-nacionalistë për të devijuar mekanizmat e zbulimit të së vërtetës duke prodhuar raporte dhe këndvështrime që ndryshojnë historinë.

**Kërkimi i personave të humbur**, proces që kontribon edhe në zbulimin e së vërtetës, ka pësuar rënie gjatë viteve të fundit, ndonëse mbeten ende edhe 9876 të humbur. Është urgjente që këto raste të mbetura të zgjidhen sa më shpejt më qëllim që t'u jepet fund vuajtjeve të familjeve. Koha e gjatë e kaluar dhe mundësia e identifikimeve të gabuara para përdorimit të testit të ADN-së paraqesin pengesa praktike të rëndësishme, ndërkohë që fatkeqësisht mungesa e përkushtimit politik për bashkëpunim të vërtetë rajonal në këtë fushë është kthyer në pengesë të madhe vitet e fundit. Janë të nevojshme përpjekje të mëtejshme për të mbrojtur më mirë të drejtat e njeriut të familjeve të personave të humbur.

Së fundmi, janë bërë disa përpjekje në rajon për të trajtuar çështjen e **vetingut për zyrtarët publikë të dyshuar apo dënuar për përfshirje në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut** gjatë luftërave të viteve 1990. Për shkak të dështimit në zbatimin e një vetingu efektiv, autorë të krimeve



të luftës dhe të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut vazhdojnë të mbajnë pozicione në shërbimin publik, përfshirë edhe poste si zyrtarë të zgjedhur. Prania e autorëve të dyshuar apo të dënuar të krimeve të luftës në institucione shtetërore apo pozicione publike ka ndikim serioz te viktimat dhe të mbijetuarit, si dhe në suksesin e përpjekjeve për sundimin e ligjit.

**Prirjet negative që minojnë përpjekjet për t'u përballur me të shkuarën.** – Jo vetëm që progresi në disa fusha të përballjes me të shkuarën është praktikisht i bllokuar, por ka edhe përpjekje të pashtershme për të minuar arritjet e mëparshme në këtë fushë. Kapitulli 3 merr në shqyrtim disa prej sfidave dhe prirjeve kryesore aktuale që qëndrojnë në themel të këtyre hapave pas. Tregohen lidhjet mes rritjes së qasjes negative ndaj përballjes me të shkuarën dhe dobësimit të demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit në disa vende të rajonit.

Së pari, ka një prirje alarmante drejt **diskursit etno-nacionalist, mohimit të krimeve dhe glorifikimit të kriminelëve të luftës**, çka dobëson përpjekjet për t'u përballur me të shkuarën. Është shqetësuese që praktika të tilla pranohen dhe ndiqen në mënyrë aktive nga politikanë në nivelet më të larta të politikës dhe që kthehen në strategji për të mbledhur vota dhe për të qëndruar në pushtet. Grupet nacionaliste të ekstremist të djathtë, gjithashtu, kontribuojnë në këtë diskurs. Këto grupe ushqehen nga lidhjet rajonale dhe ndërkombëtare dhe janë faktor serioz rreziku që minon përpjekjet për të parandaluar përsëritjen e dhunës. Është dëshmuar se proceset e papërfunduara të përballjes me të shkuarën rrisin radikalizimin dhe ekstremizmin e djathtë. Politikanë të caktuar, drejtues fetarë, figura publike dhe historianë, gjithashtu, kontribuojnë në mënyrë aktive në ndryshimin e historisë dhe në përpjekjet për të rilegjitur dhe çimentuar pozitat e krimelëve të luftës. Përhapja e ideologjive përçarëse dhe mohimi i krimeve të luftës përshpejtohet nga disa media tradicionale dhe media sociale.

Qasja negative e disa mediave ndaj drejtësisë tranzitore reflekton sfidat më të mëdha që vijnë për shkak të përkeqësimit të lirisë së medias dhe gazetarisë profesionale në rajon.

Përkundrajt këtij konteksti, e shkuara krijon përçarje të thella si brenda, ashtu edhe ndërmjet vendeve të rajonit. Kjo krijon një klimë urrejtjeje dhe ndasie, çka reflektohet edhe në rritjen e mirëdokumentuar të gjuhës së urrejtjes, dhunës ndëretnike dhe intolerancës. Gjuha e urrejtjes shpesh përfshin referenca historike. Ka incidente dhune të përsëritura, veçanërisht ndaj ndërtesave fetare dhe kulturore dhe ndaj të rikthyerve që bëjnë pjesë të pakicat etnike. Kjo rrënjos frikën dhe përbën një pengesë madhore për bashkëjetësen paqësore dhe krijimin e besimit. Nevojiten reagime të shpejta politike për të shmangur një rikthim të dhunës masive në rajon. Kjo përfshin tolerancë zero ndaj krimeve të urrejtjes dhe strategji gjithëpërfshirëse për trajtimin e gjuhës së urrejtjes. Duke parë kontekstin e paqëndrueshëm në rajon dhe prirjet e theksuara më lart, është provuar

të jetë e nevojshme kriminalizimi i mohimit të gjenocidit dhe krimeve të luftës, si një formë e rëndë e gjuhës së urrejtjes.

**Shoqëria civile dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut** që punojnë në fushën e përbaljes me të shkuarën hasen me një mjedis gjithnjë e më të vështirë. Ata preken nga një përkeqësim më i përgjithshëm që ndikon te shoqëria civile dhe OJQ-të. Këtu përfshihen masat kufizuese nga qeveritë dhe armiqësia, përfshirë atë on-line, nga disa aktorë joshtetërorë dhe pjesëtarë të publikut. Po kështu, mbrojtësit e të drejtave të njeriut që punojnë për përbaljen me të shkuarën ndeshin pengesa që lidhen specifkisht me problemet që mbulojnë dhe me faktin që ata sfidojnë narrativën mbizotëruese në komunitetin apo vendin e tyre. Atabëhen objekt i fushatave të shpifjeve, të ngacmimeve me natyrë ligjore dhe të dështimeve për të parandaluar sulmet ndaj aktiviteteve që organizojnë. Burimet për punën në fushën e përbaljes me të shkuarën janë zvogëluar dhe shumë prej mbrojtësve të të drejtave të njeriut përballen me raskapitje dhe ankth, çka mund të çojë në sëmundje fizike dhe psikologjike.

Thuajse tri dekada pas luftërave, **dimensioni i përbaljes me të shkuarën ndër breza** është një aspekt që kërkon vëmendje të menjëhershme. Brezat e rinj po rriten në shoqëri të ndara, pa mundësi të vërteta që të ndërveprojnë më anëtarët e grupit tjetër ose po edukohen që ta shohin "tjetrin" si kërcënim. Të dhënat për radikalizimin e të rinjve dhe disa incidente të dhunshme ku përfshihen të rinj përbëjnë shqetësim shumë serioz. Prirja për t'i ndarë fëmijët sipas gjuhës dhe/ose grupit etnik në sistemin arsimor është ngulitur në disa prej vendeve të rajonit. Kjo ka ndikim negativ të madh në kohezionin social dhe pajtimin e shoqërive multi-etnike. Politikat zyrtare të kujtesës janë të njëanshme, me fokus nderimin e veteranëve dhe narrivat nacionaliste, dhe priren të mohojnë vuajtjet e viktimave që i përkasin grupeve të tjera etnike. Pavarësisht projekteve të shumta me qëllim përmirësimin e mësimdhënies së historisë në shkolla, ende nuk është arritur të nxitet të menduarit kritik, empatia historike dhe këndvështrimet e shumëfishta. Kurrikula zyrtare e historisë përgjithësisht shmang diskutimin e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut të kryera ndaj grupeve të tjera, apo edhe tema të tjera sensitive.

Një faktor tjetër i rëndësishëm që minon proceset e përbaljes me të shkuarën në rajon është **dështimi i qeverive gjatë dekadave të fundit që të adresojnë rrënjët e vërteta të luftërave**. Fokusimi te trajtimi i krimeve të kryera gjatë luftërave, ndonëse i rëndësishëm, la pa vëmendje të pamjaftueshme reformimin e strukturave institucionale dhe modeleve shoqërore që mundësuan kryerjen e këtyre krimeve në krye të herës. Pasojat e moskryerjes së reformave më të gjera, me ndjeshmëri ndaj së shkuarës, vazhdojnë të minojnë progresin demokratik dhe paqen në rajon. Këto shkaqe përfshijnë ndarjen e padrejtë të pushtetit, klientelizmin dhe korrupsionin. Diskriminimi mbi bazë etnie në disa raste është rrënjësor më thellë në kushtetutën dhe legjislacionin e rajonit. Dobësia e institucioneve publike dhe mungesa e besimit të publikut ndaj tyre vazhdon të mbetet

problem, përfshirë dhe një kulturë dhune që vihet re në institucionet e sigurisë. Mostrajtimi i karakteristikave mashkullore të militarizimit dhe dhunës ka penguar jo vetëm trajtimin e dhunës seksuale të lidhur me konfliktet, por edhe reagimin ndaj dhunës me bazë gjinore në rajon sot.

**Rruga përpara** - Po bëhet gjithnjë e më vështirë që të përmbysen prirjet negative që minojnë përpjekjet për t'u përballur me të shkuarën dhe për të arritur paqen dhe pajtimin në rajon. Kapitulli 4 i këtij Dokumenti Tematik vë në dukje katër fusha prioritare në rrugën për të përparuar. Thekson në mënyrë të vazhdueshme se udhëheqësit politikë dhe autoritetet kombëtare kanë përgjegjësinë kryesore për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut në këtë fushë dhe për të punuar me sinqeritet për arritjen e paqes dhe kohezionit social.

Fusha e parë e fokusit duhet të jetë që të sigurohet vendosja e **viktimave dhe të mbijetuarëve në qendër të të gjitha proceseve të drejtësisë tranzitore**. Duke pasur parasysh sa kohë ka kaluar tashmë, është nevojë urgjente që të përshpejtohet ritmi i ndjekjes penale të krimeve të luftës. E njëjta gjë vlen edhe për kërkimin e së vërtetës, ku duhet të rigjallërohen përpjekjet për gjetjen e personave të humbur. Shtetet e rajonit duhet, më në fund, të përmbushin detyrimet e tyre ndërkombëtare në fushëm e reparacioneve. Kjonënkupton sigurimin e aksesit të viktimave në formë reparacioni jodiskriminuese dhe të plota, përfshirë pranimin simbolik, ndjesën, reparacionin psikologjik dhe formë të tjera të reparacioneve transformuese, të mbështetura nga një pranim/njohje e sinqerte në nivel politik. Po kështu, është e nevojshme të bëhen më të dukshëm disa tipe viktimash që kanë qenë më pak të pranishme në proceset e drejtësisë tranzitore, siç janë grupet e minoriteteve, gratë dhe fëmijët. Autoritetet kombëtare duhet të riangazhohen në mënyrë urgjente dhe të dyfishojnë përpjekjet në këto fusha.

Së dyti, është thelbësore që të vihet me shumë theksi te **parandalimi dhe ndërtimi i një të ardhmeje me më pak gjasa për ripërsëritje të dhunës**. Përtej fokusit të nevojshëm për ndërtimin e autoriteteve të forta dhe të qëndrueshme të zbatimit të ligjit, duhet t'i kushtohet vëmendje dimesionit të drejtësisë tranzitore ndër breza. Thuajse tri dekada pas përfundimit të luftërave arsimit i integruar, përmirësimi i mësimdhënies së historisë, hapja dhe ruajtja e arkivave dhe përkujtimi i bazuar në të drejtat e njeriut janë kthyer në fusha të rëndësishme sot në rajon. Këtu fokusi duhet të jetë te ligjet dhe strategjitë që ndihmojnë në mënyrë kuptimplote luftën kundër mohimit të krimeve dhe ndryshimit të së shkuarës. Është po aq thelbësore të investohet te të rinjtë si agjentë të ndryshimit, nëpërmjet vendosjes së kontakteve specifike dhe duke u mbështetur gjerësisht te ky grup për formulimin e politikave në këtë fushë.

Së treti, është shumë e rëndësishme **të fuqizohet mbështetja politike dhe financiare për shoqërinë civile që punon për drejtësinë tranzitore**. Puna e shoqërisë civile në rajon vazhdon të mbetet kyçe për përfshirjen në drejtësinë tranzitore dhe për gjetjen e mënyrave të reja me qëllim krijimin e një mjedisi ku të realizohet përkujtimi jopërçarës, pajtimi dhe paqja. Mes



të tjerave, fuqizimi i shoqërisë civile kërkon konsultim efektiv dhe mundësi qasjeje ndaj politikëbërësve në rastet e ligjeve dhe politikave që lidhen me këtë fushë. Shoqëria civile ka nevojë për financim të qëndrueshëm dhe fleksibël me qëllim që të vazhdojë punën për përballjen me të shkuarën në periudhë afatgjatë; këtu mbështetja institucionale nga autoritetet kombëtare është thelbësore. Aktivitetet për parandalimin e dhunës duhet të mbështeten. Aktivistëve që përjetojnë të ashtuquajturën traumë sekondare (shenja të traumës që përjetohej nga ata që përkujdesen për personat e traumatizuar) ose që përballen me ngacmime për shkak të angazhimit të tyre në fushën e përballjes me të shkuarën duhet t'u ofrohet ndihma psikosociale. Mbrojtësit e të drejtave të njeriut janë shpresa më e mirë për një të ardhme më të mirë bazuar në të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit.

**Hapat pas në drejtësinë tranzitore duhet të adresohen në mënyrë strategjike, kryesisht nëpërmjet qasjeve rajonale dhe investimit më të madh në nivel lokal.** Përgjegjësinë kryesore e kanë shtetet e rajonit dhe përfaqësuesit e tyre me qëllim që të sigurojnë mjedis inkurajues për këtë punë të rëndësishme, të çliruar nga frika dhe propaganda e rrezikshme dhe dezinformimi për të shkuarën. Partnerët ndërkombëtarë duhet të vazhdojnë të japin mesazhe të qarta mbi rëndësinë e përballjes me të shkuarën gjatë ndërveprimeve të tyre me shtetet e rajonit dhe duhet të ndjekin në vijimësi rekomandimet e shumta e të vlefshme që janë formuluar më parë nga organizatat ndëkomëtare dhe organizmat për të drejtat e njeriut. Duke parë ndërvarësinë mes sfidave të së shkuarës dhe të së tashmes, shtetet e rajonit duhet të hartojnë plane veprime për drejtësinë tranzitore për t'u përdorur gjatë vlerësimit të progresit në nivel rajonal. Koordinimi rajonal, qasjet dhe strategjitë duhet të inkurajohen më tej dhe njëherazi duhet të rifokusohet veprimi në nivel lokal, në nivel bazë dhe komuniteti, atje ku përballja me të shkuarën kthehet në diçka konkrete dhe ku është nevoja që të gjenden zgjidhjet për pajtim dhe paqe.